



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE
DREJTORIA E PROCEDURAVE TË REKRUTIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL

Në përgjigje të kërkesës suaj të datës 18.04.2025, lënda “Kërkesë për informacion në bazë të ligjit nr. 119/2014”, protokolluar me tonën me nr. 2716 Prot., datë 25.04.2025, Departamenti i Administratës Publike (DAP) shprehet si vijon:

Së pari ju sqarojmë bazën ligjore që rregullon organizimin dhe zhvillimit të procedurave të rekrutimit në shërbimin civil.

DAP në cilësinë e njësisë përgjegjëse, në zbatim të legjislacionit të shërbimit civil, pas miratimit të vendimit nr. 62, datë 07.02.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimit në vitin 2025 në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil”, dhe vendimit nr. 110, datë 19.02.2025, “Për hapjen e procedurës së pranimit në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil, për vitin 2025”, ka vijuar me publikimin në faqen zyrtare të procedurave të konkurrimit.

Në zbatim të nenit 25, të ligjit nr. 125/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të VKM-së nr. 243, datë 18.03.2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar dhe VKM-së nr. 242, datë 18.03.2015, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, i ndryshuar, plotësimi i vendeve të lira në kategorinë ekzekutive, atë të ulët apo të mesme drejtuese bëhet së pari nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele. Në rastet kur një vend vakant në kategorinë ekzekutive, të nivelit të ulët apo të mesëm drejtues nuk plotësohet nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, njësia përgjegjëse shpall procedurën e ngritjes në detyrë apo të pranimit nga jashtë në shërbimin civil.

Vlerësimi i kandidatëve pjesëmarrës në procedurat e konkurrimit bëhet nga anëtarët e komiteteve të pranimit, në zbatim të ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar, dhe VKM-ve nr. 243 dhe nr. 242, datë 18.03.2015, të ndryshuara. Në përfundim të vlerësimit, komitetet e pranimit përcjellin pranë njësisë përgjegjëse DAP, vendimin e përzgjedhjes së kandidatit që është renditur i pari ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 për qind të pikëve; listën e kandidatëve fitues, që marrin mbi 70 për qind të pikëve totale të vlerësimit; ose vendimin e përfundimit të procedurës pa asnjë të përzgjedhur, respektivisht sipas procedurës së ndjekur. Ky vendim dërgohet pranë njësine përgjegjëse së bashku me listën e kandidatëve që kanë konkurruar të renditur sipas pikëve. Njësia përgjegjëse DAP njofton individualisht kandidatët që kanë konkurruar për rezultatin e tyre, brenda 24 (njëzetëkatër) orëve nga dita që komiteti i njofton vendimin e tij.

Afatet e ankimit sipas procedurave së konkurrimit të zhvilluara janë të përcaktuara në VKM-të nr. 243 dhe nr. 242, datë 18.03.2015, të ndryshuara. Kandidatët kanë të drejtë të paraqesin ankim me shkrim pranë komiteteve të pranimit për vlerësimin e rezultatit, brenda 3 (tri) ose 5 (pesë) ditëve

kalendarike nga data e njoftimit individual të rezultatit, sipas procedurës së ndjekur. Komiteti i pranimit jep përgjigje brenda 3 (tri) ose 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit. Pavarësisht kësaj, kandidatët ruajnë të drejtën për t'u ankuar edhe në gjykatën administrative.

Në rastet e procedurave të konkurrimit kur kandidati i vetëm pjesëmarrës ka rezultuar fitues, paraqitet në DAP dhe deklaron brenda afatit të ankimit mungesën e çdo pretendimi apo ankese mbi rezultatin, vijohet me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Në këto kushte vijohet me nxjerrjen e aktit të emërimit në përputhje me afatet e parashikuara në legjislationin e shërbimit civil dhe në respektim të parimeve të Kodit të Procedurave Administrative.

Së dyti, sa i përket pyetjeve tuaja ju informojmë si vijon:

Procedurat e konkurrimit të zhvilluara në datat 7, 8, 9 dhe 10 prill 2025, janë si më poshtë:

- Në datën 07.04.2025, janë zhvilluar 8 procedura konkurrimi për 10 pozicione vakante;
- Në datën 08.04.2025, janë zhvilluar 7 procedura konkurrimi për 8 pozicione vakante;
- Në datën 09.04.2025, janë zhvilluar 9 procedura konkurrimi për 13 pozicione vakante;
- Në datën 10.04.2025, janë zhvilluar 6 procedura konkurrimi për 6 pozicione vakante;

Procedurat e konkurrimit të përfunduara me një vendim përzgjedhje nga ana e anëtarëve të komiteteve të pranimit janë:

- Për datën 07.04.2025, janë plotësuar 5 pozicione vakante;
- Për datën 08.04.2025, është plotësuar 1 pozicion vakant;
- Për datën 09.04.2025, është plotësuar 1 pozicion vakant;
- Për datën 10.04.2025, janë plotësuar 3 pozicione vakante.

Sa i takon pyetjes tuaj mbi afatet e ankimit për procedurat e konkurrimit, ju informojmë se në datat e sipërpërmendura janë zhvilluar procedura konkurrimi për lëvizjen paralele dhe pranimit nga jashtë shërbimit civil në kategorinë ekzekutive, lëvizje paralele, ngritje në detyrë dhe pranim nga jashtë shërbimit civil në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese. Më konkretisht:

- Për procedurat e konkurrimit lëvizje paralele në kategorinë ekzekutive, në zbatim në pikës 18, të kreut VII, të VKM-së nr.243, datë 18.03.2015, i ndryshuar, kandidatët kanë të drejtë të bëjnë ankim me shkrim në Komisionin e Brendshëm për Lëvizjen Paralele për rezultatin e vlerësimit, brenda 3 (tri) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual mbi rezultatin. Ankuesi merr përgjigje brenda 3 (tri) ditëve kalendarike, nga data e përfundimit të afatit të ankimit.
- Për procedurat e pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive, në zbatim të pikës 22, të kreut IV, të VKM-së nr. 243, datë 18.03.2015, i ndryshuar, afati i ankimit fillon brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga: a) data e njoftimit individual të rezultatit të vlerësimit me shkrim, për kandidatët që kanë grumbulluar deri në gjysmën e pikëve (deri në 30 pikë) nga ky

vlerësim; b) data e njoftimit individual të rezultatit të vlerësimeve, për kandidatët që kanë grumbulluar deri në 45 pikë nga vlerësimi me shkrim dhe vlerësimi i jetëshkrimit; c) data e njoftimit individual të rezultatit të vlerësimeve, për kandidatët të cilët kanë marrë pjesë në të tre fazat e vlerësimit të përcaktuara sipas pikës 7, të kreut IV, të këtij vendimi. Të gjithë ankuesit marrin përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit ankimor të përcaktuar në shkronjën “c”, të kësaj pike.

- Për procedurat e lëvizjes paralele në kategorinë e ulët dhe të meme drejtuese, në zbatim të pikës 27, të kreut II, të VKM-së nr. 242, datë 18.03.2015, i ndryshuar, kandidati ka të drejtë të bëjë ankim me shkrim në Komitetin e Pranimit për Lëvizjen Paralele, për rezultatin e pikëve, brenda 3 (tri) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual për rezultatin e vlerësimit. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.
- Për procedurat e ngritjes në detyrë në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese, në zbatim të pikës 35, të kreut III, të VKM-së nr. 242, datë 18.03.2015, i ndryshuar, kandidati, pavarësisht nga e drejta për t’u ankuar në gjykatën administrative, ka të drejtë të bëjë ankim me shkrim edhe në Komitetin e Përhershëm të Ngritjes në Detyrë (KPND) për rezultatin e pikëve, brenda 3 (tri) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual për rezultatin e vlerësimit. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

Referuar pyetjes së fundit, sqarojmë se për procedurat e konkurrimit të zhvilluara në datat e sipërpërmendura, kur anëtarët e komiteve kanë bërë me dije njësinë përgjegjëse mbi vendimin e tyre sipas parashikimeve ligjore, DAP ka njoftuar individualisht kandidatin/tët që kanë marrë pjesë në procedurë për rezultatin e tyre, brenda 24 (njëzetëkatër) orëve nga dita e njoftimit të vendimit.

Për të gjitha vendet vakante të plotësuara në përfundim të procedurave të konkurrimit, në datat e sipërcituara, referuar vendimit të përzgjedhjes nga anëtarët e komiteve, sqarojmë se janë procedura në të cilat ka patur një kandidat pjesëmarrës, i cili ka rezultuar dhe fitues. Kandidati është paraqitur në DAP dhe ka deklaruar se nuk ka ankesë brenda afatit të ankimit mbi rezultatin, si dhe ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit sipas ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, është vijuar me nxjerrjen e aktit të emërimit në përputhje me afatet e parashikuara në legjislacionin e shërbimit civil. Ky veprim është realizuar në përputhje të plotë me parimet themelore të së drejtës administrative, të përcaktuara në nenet 3, 5, 12 dhe 18 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", duke garantuar një procedurë efikase, transparente dhe të drejtë, por edhe duke siguruar funksionalitetin dhe vazhdimësinë e administratës publike në përputhje me objektivat e shërbimit civil.

Ndërkohë, sa i takon procedurave të tjera të konkurrimit të zhvilluara në datat e sipërpërmendura, sqarojmë se ato janë ende në proces në respektim të afateve të ankimit, të përcjelljes së vendimeve nga ana e anëtarëve të komiteve si dhe vendimit nr. 19 datë 08.04.2025, "Për pezullimin e procedurave të konkurrimit përgjatë periudhës 11.04.2025-11.05.2025", sipas të cilit DAP, në cilësinë e njësisë përgjegjëse për mirëadministrimin e shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore, vendosi mospublikimin e vendeve vakante të shërbimit civil të

institucioneve të administratës shtetërore dhe pezullimin e procedurave administrative të rekrutimit, të shpallura në faqen zyrtare të Departamentit të Administratës Publike, përgjatë periudhës së fushatës zgjedhore dhe heshtjes zgjedhore nga data 11.04. 2025 -11.05.2025, bazuar në nenet 91 dhe 92, të “Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 122, datë 26.02.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet e përgjithshme për vitin 2025”, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, të agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare, njerëzore dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, të ndryshuar. Të gjitha procedurat e rekrutimit do të rinisin duke filluar nga data 12.05.2025 në fazën ku janë ndërprerë.

Si përfundim, ju bëjmë me dije se, kërkesa juaj për informim është regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve 2025 të DAP-it, me numrin rendor 10, sipas detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", të ndryshuar. Për çdo kërkesë tjetër për informim ju mund t'i drejtoheni adresës së kontaktit info@dap.gov.al

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,